



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 25/19 prot.

Tiranë, më 18.02.2021

VENDIM

Nr. 07, datë 18.02.2021

PËR
NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN NR. 6 DATË 17.02.2021 TË KOMISIONERIT
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të nenit 112 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

KONSTATOVA SE:

Në Vendimin nr. 6 datë 17.02.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konkretisht në paragrafin e fundit të faqes tre dhe fillimin e faqes katër, konstatova një gabim material i cili korrigjohet si vijon:

“Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesja e Kontrolluesit. Në datën 26.01.2021 Kontrolluesi “Commercee Corp” SHPK – BIOTE nëpërmjet shkresës nr. 152 Prot., paraqiti pretendimet e veta lidhur me procesverbalin e mbajtur nga grupi i kontrollit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në datën 26.01.2021 u dërgua me postë zyrtare njoftimi për pjesëmarrje në seancën dëgjimore të datës 01.02.2020. Njoftimi u kthye nga posta me motivacionin “adresë e panjohur”, pavarësisht faktit që kjo është adresa zyrtare e publikuar në ekstraktin e regjistrimit tregtar nga Kontrolluesi dhe nga grupi i hetimit është kryer hetimi

administrativ në terren. Në vijim, në datën 03.02.2021, Zyra e Komisionerit ka njoftuar Kontrolluesin nëpërmjet postës elektronike, nga ku ka marrë dhe konfirmimin e tij për zhvillimin e seancës dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 08.02.2021 me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të kontrolluesit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit në seancë pati deklarata kontradiktore dhe të paqarta por nuk paraqiti asnjë provë të re dhe argument në lidhje me konstatimet e reflektuar në procesverbalin e mbajtur nga grupi i hetimit administrativ dhe në përfundim u qëndroi atyre pretendimeve të paraqitura me shkresën nr. 152 Prot 26.01.2021 nga Kontrolluesi”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 112 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VENDOSA:

1. Korrigjimin e Vendimit nr. 6 datë 17.02.2021, vetëm për sa i përket paragrafit të fundit të faqes tre dhe fillimin e faqes katër.
2. Kthimin e Vendimit i cili i nënshtrohet korrigjimit, nga palët të cilëve iu është vendosur në dispozicion.
3. Ky vendim u shpall sot datë 18.02.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

